



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR**

Nr. 12738/4 Prot.

Tiranë, më 9.7.2026

**RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË SINJALIZIMIT DHE TË MBROJTJES
SË SINJALIZUESVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE
TË TRANSPORTIT RRUGOR**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo rregullore për përcaktimin e rregullave të sinjalizimit dhe të mbrojtjes së sinjalizuesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRR” ose “Organizata”) miratohet në bazë dhe në zbatim të:

- a) ligjit nr. 96/2025, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” (në vijim “ligji”), në veçanti të nenit 14, pika 3, e të nenit 28, pika 3, të tij;
- b) Kodit të Procedurave Administrative;
- c) Vendimit nr. 395, datë 28.5.2026, të Këshillit të Ministrave “Për marrëdhëniet e punës, strukturën dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të njësive përgjegjëse të sinjalizimit në autoritetet publike” (në vijim “VKM nr. 395/2026”);
- ç) aktit të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së për krijimin e Njesisë Përgjegjëse për Sinjalizimin, miratuar në zbatim të ligjit dhe të VKM nr. 395/2026;
- d) urdhrave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ILDKPKI-ja.

Kjo rregullore zbatohet së bashku dhe në harmoni me Rregulloren për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor, miratuar njëkohësisht, në zbatim të nenit 20, pika 8, të ligjit.

**Neni 2
Objekti dhe qëllimi**

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për krijimin dhe funksionimin e Njesisë Përgjegjëse, procedurën e sinjalizimit, dhe mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve, të ndihmësve dhe të personave të lidhur me ta, nga veprimet hakmarrëse, në zbatim të nenit 14, pika 3, të ligjit.
2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është nxitja e sinjalizimit të shkeljeve të mundshme të kuadrit ligjor në veprimtarinë e DPSHTRR-së, garantimi i një mjedisi pune të sigurt dhe i mbrojtjes



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Pallati Bjorn, Tiranë AL, 1010;
Tel.: +355 68 801 5833; Fax.: +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

efektive të sinjalizuesve nga çdo formë hakmarrjeje, si dhe trajtimi i drejtë dhe i shpejtë i sinjalizimeve dhe i kërkesave për mbrojtje, duke pasur parasysh tagrin e ILDKPKI-së, si autoritet kompetent, kundrejt DPSHTRR-së.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për çdo sinjalizim që raportohet ose disponohet nga një person në kontekst pune me DPSHTRR-në, për veprime ose mosveprime të kundërligjshme që çenojnë interesin publik, duke përfshirë, ndër të tjera, keqpërdorimin e funksionit, korrupsionin, keqadministrimin e fondeve publike a të donatorëve, shkeljet në fushën e prokurimit publik, të sigurisë e cilësisë së punimeve apo shërbimeve, të mjedisit, si dhe çdo veprim tjetër që çënon transparencën, llogaridhënien dhe integritetin në veprimtarinë e Organizatës, sipas fushave të përcaktuara në nenin 3 të ligjit.
2. Kjo rregullore zbatohet për çdo person që sinjalizon një shkelje të mundshme ligjore gjatë angazhimit në një kontekst pune me DPSHTRR-në, sipas nenit 2 të ligjit, përfshirë punonjësit aktual, kandidatët në proces rekrutimi, ish-punonjësit, personat e vetëpunësuar, anëtarët e organeve drejtuese a mbikëqyrëse, praktikantët, si dhe personat që punojnë për ose nën drejtimin e kontraktorëve, nënkontraktorëve a furnitorëve të DPSHTRR-së.
3. Kjo rregullore zbatohet edhe për sinjalizimet anonime dhe për sinjalizimet publike, sipas kushteve të përcaktuara në ligj dhe në nenin 10 të kësaj rregulloreje.
4. Dispozitat e kreut IV, V dhe VI të kësaj rregulloreje, që rregullojnë mbrojtjen nga veprimet hakmarrëse, zbatohen, përshtatshmërisht, edhe për ndihmësin dhe për personat e lidhur me sinjalizuesin.
5. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit dhe masat e veçanta për mbrojtjen e konfidencialitetit rregullohen në Rregulloren për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime, në përputhje me nenin 4 të ligjit:

1. “Autoriteti kompetent” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), i caktuar për të pranuar, shqyrtuar dhe ndjekur sinjalizimet e jashtme, për të shqyrtuar kërkesat për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse, për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit nga DPSHTRR-ja, si dhe, në përgjithësi, për të garantuar mbrojtjen e sinjalizuesit.
2. “Organizata” është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila gëzon statusin e një institucioni publik dhe ushtron aktivitetin e saj në zbatim të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, përfshirë VKM nr.343, datë 21.07.1999, për krijimin dhe funksionimin e institucionit.
3. “Hakmarrje” ose “veprim hakmarrës” është çdo veprim ose mosveprim, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i kryer nga DPSHTRR-ja ose nga punonjës të saj, që rezulton nga sinjalizimi dhe



që dëmton ose mund të dëmtojë në mënyrë të padrejtë interesat e ligjshëm të sinjalizuesit, përfshirë format e parashikuara në nenin 18 të kësaj rregulloreje.

4. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

5. “Informacion për shkeljet” është çdo lloj informacioni që përmban dyshime të arsyeshme dhe lidhet me shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera ose që ka gjasa të kryhen, të përfutuara në një kontekst pune në DPSHTRR.

6. “Kontekst pune” është çdo marrëdhënie profesionale, aktuale, e mëparshme ose e mundshme me DPSHTRR-në, përmes së cilës një person ka akses në informacione për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor.

7. “Ligji” është ligji nr. 96/2025, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

8. “Masa të përkohshme” janë masat e urdhëruara nga ILDKPKI-ja, me akt të ndërmjetëm të arsyetuar, për pezullimin e çdo veprimi hakmarrës ndaj sinjalizuesit deri në përfundimin e hetimit të kërkesës për mbrojtje.

9. “Ndihmës” është çdo person që ndihmon një sinjalizues gjatë procesit të sinjalizimit në një kontekst pune dhe ndihma e tij është konfidenciale.

10. “Njësia Përgjegjëse” ose “NJP” është organi i posaçëm, i krijuar brenda DPSHTRR-së, i përbërë nga një ose më shumë punonjës, i ngarkuar me pranimin, regjistrimin dhe hetimin administrativ të sinjalizimeve, sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, me shqyrtimin e kërkesave për mbrojtjen e sinjalizuesit nga veprimet hakmarrëse, me bashkëpunimin me ILDKPKI, si dhe me detyra të tjera të parashikuara nga ligji dhe nga kjo rregullore.

11. “Person i lidhur me sinjalizuesin” janë bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit, si dhe kolegët e të afërmit, që punojnë për të njëjtin punëdhënës ose që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin kontekst pune.

12. “Person i përfshirë” ose “person i sinjalizuar” është çdo person fizik ose juridik që përmendet në sinjalizim ose në publikim si personi të cilit i atribuohet shkelja ose që ka lidhje me autorin e shkeljes.

13. “Shkelje” është çdo veprim ose mosveprim i paligjshëm, që ka ndodhur ose ka gjasa të ndodhë dhe për të cilin ka shkaqe të arsyeshme për ta konsideruar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

14. “Sinjalizim” është raportimi ose sinjalizimi i informacionit, verbal ose me shkrim, nga sinjalizuesi tek NJP ose tek ILDKPKI-ja, për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, nëpërmjet kanaleve të brendshme, të jashtme ose nëpërmjet publikimit.

15. “Sinjalizim anonim” është sinjalizimi i kryer nga një sinjalizues, identiteti i të cilit nuk është i njohur për NJP-në ose për ILDKPKI-në në momentin e paraqitjes ose kur sinjalizuesi vetë ka kërkuar të mbetet anonim.

16. “Sinjalizim i brendshëm” është sinjalizimi i kryer nga sinjalizuesi pranë NJP-së.

17. “Sinjalizim i jashtëm” është sinjalizimi i kryer nga sinjalizuesi pranë ILDKPKI-së.

18. “Sinjalizim publik” është sinjalizimi, zbulimi ose komunikimi publik i informacionit për shkelje të mundshme, sipas kushteve të përcaktuara në ligj dhe në nenin 10 të kësaj rregulloreje.

19. “Sinjalizues” është çdo person fizik që në një kontekst pune me DPSHTRR-në, sinjalizon ose publikon informacione për shkelje të mundshme, sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje.



KREU II

PARIMET DHE NJËSIA PËRGJEGJËSE PËR SINJALIZIMIN

Neni 5

Parimet e përgjithshme

1. Procesi i sinjalizimit në DPSHTRR udhëhiqet nga parimi i integritetit dhe i konfidencialitetit, sipas të cilit pjesëmarrësit në procedurën administrative kanë të drejtë që të dhënat e tyre personale e konfidenciale të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe nga parimi i paanshmërisë, sipas të cilit shqyrtimi dhe zgjidhja e sinjalizimeve kryhet në mënyrë objektive, pavarësisht nga bindjet dhe interesat e personave përgjegjës për trajtimin e tyre.
2. Në veprimtarinë e saj, NJP bazohet, gjithashtu, në parimet e:
 - a) sinjalizimit vullnetar dhe në mirëbesim të shkeljeve të mundshme të kuadrit ligjor;
 - b) pavarësisë në ushtrimin e kompetencave, jashtë çdo influence politike ose të padrejtë;
 - c) shmangies së çdo konflikti interesi, përpara dhe gjatë hetimit administrativ;
 - ç) marrjes së të gjitha masave të përshtatshme për mbrojtjen e dokumentacionit dhe të provave nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi ose asgjësimi;
 - d) ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit, si dhe të sekretit shtetëror, kur është rasti, në përmbajtje të sinjalizimit;
 - dh) trajtimit të shpejtë dhe të besueshëm të hetimit administrativ të sinjalizimit;
 - e) garantimit të aksesit në të gjitha format e sinjalizimit, verbale, me shkrim, ose nëpërmjet mjeteve të tjera të njohura të komunikimit.

Neni 6

Përbërja e Njesisë Përgjegjëse

1. DPSHTRR-ja krijon dhe garanton funksionimin efektiv të Njesisë Përgjegjëse për Sinjalizimin (NJP), si mekanizëm i dedikuar për pranimin, regjistrimin dhe ndjekjen e sinjalizimeve të brendshme, në zbatim të nenit 14 të ligjit dhe të VKM-së nr. 395/2026.
2. Njesisë Përgjegjëse për Sinjalizimin (NJP) në DPSHTRR përbëhet nga drejtuesi i njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe 1 (një) punonjësi i saj;
3. Emërimi i punonjësit në NJP bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, pas dhënies së pëlqimit me shkrim nga punonjësi i propozuar dhe i njoftohet me shkrim ILDKPKI-së, së bashku me kontaktet e NJP-së.
4. Punonjësit e NJP-së duhet të jenë të trajnuar posaçërisht në fushën e sinjalizimit dhe të mbrojtjes së sinjalizuesve.
5. Caktimi i punonjësit në detyrën e NJP-së bëhet pranë detyrave dhe funksioneve të pozicionit të tij të punës, sipas aktit të emërimit, është pa afat dhe përfundon vetëm në rastet e parashikuara në nenin 7, pika 4, të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Pavarësia, mbrojtja dhe largimi i punonjësve të Njesisë Përgjegjëse

1. Punonjësi i ngarkuar me trajtimin e sinjalizimeve gëzon pavarësi në ushtrimin e kompetencave të tij, veçanërisht kur sinjalizimi lidhet me veprimtarinë e punëdhënësit ose



përfshin masa për mbrojtjen e sinjalizuesit dhe e ushtron detyrën jashtë çdo influence të padrejtë që mund të pengojë realizimin e saj.

2. Punonjësit e NJP-së garantojnë në çdo kohë ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit dhe mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesit, në përputhje me dispozitat për konfidencialitetin e parashikuara në Rregulloren për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, si dhe shmangin çdo situatë konflikti interesi.

3. Punonjësi i autorizuar për regjistrimin dhe shqyrtimin e sinjalizimeve gëzon, vetë, të drejtën e mbrojtjes sipas ligjit, nëse bëhet objekt i veprimeve hakmarrëse për shkak të ushtrimit të detyrës.

4. Punonjësi i NJP-së largohet nga kjo detyrë me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, kur:

- a) jep dorëheqjen me shkrim nga detyra, e cila i dërgohet njëkohësisht edhe ILDKPKI-së;
- b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- c) kryen shkelje të rëndë të legjislacionit që rregullon sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;
- ç) përfundon marrëdhënien e punës me DPSHTRR.

5. Për çdo ndërprerje të marrëdhënies së punës me punonjësin e NJP-së, DPSHTRR-ja njofton menjëherë ILDKPKI-në. Drejtori i Përgjithshëm merr masat e nevojshme që punonjësi i larguar të zëvendësohet menjëherë, sipas kritereve të parashikuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

6. DPSHTRR-ja siguron kushtet dhe mjetet e nevojshme të punës e të komunikimit, në mënyrë që punonjësit e NJP-së të ushtrjnë efektivisht detyrat e tyre.

Neni 8

Detyrimet e Njesisë Përgjegjëse

NJP ka detyrimin:

- a) të pranojë, të regjistrojë dhe të konfirmojë marrjen e sinjalizimit, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e paraqitjes, përveç rasteve kur sinjalizuesi ka kërkuar shprehimisht të mos marrë konfirmim ose kur konfirmimi rrezikon mbrojtjen e identitetit të tij;
- b) të ndjekë me përgjegjshmëri dhe të informojë sinjalizuesin për ecurinë e sinjalizimit dhe për rezultatin përfundimtar, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e konfirmimit të regjistrimit, pavarësisht nëse konfirmimi është dërguar ose jo;
- c) të sigurojë që kanalet e sinjalizimit të organizohen e të funksionojnë në mënyrë të sigurt, duke garantuar konfidencialitetin e identitetit të sinjalizuesit dhe të çdo personi të tretë të përmendur në sinjalizim, si dhe duke parandaluar aksesin e paautorizuar ndaj informacionit;
- ç) të sigurojë informacion të qartë dhe të nevojshëm për procedurat e raportimit të brendshëm, mënyrën e përdorimit të tyre dhe masat e mbrojtjes për sinjalizuesin;
- d) të informojë automatikisht sinjalizuesin, pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë, për veprimet e ndërmarra ose të parashikuara, si dhe për arsyetimin përkatës;
- dh) nëse sinjalizimi merret nga një punonjës i DPSHTRR-së që nuk është i autorizuar të veprojë sipas ligjit, ky punonjës e përcjell pa vonesë sinjalizimin te NJP, duke ruajtur identitetin e sinjalizuesit dhe çdo informacion që mund ta zbulojë atë.



KREU III

PROCEDURA E SINJALIZIMIT

Neni 9

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet pranë NJP-së, me çdo mjet komunikimi: me shkrim, përmes një linje të dedikuar telefonike ose pajisjeve të tjera të regjistrimit zanor ose verbalisht, në një takim fizik, brenda një afati të arsyeshëm.
2. Sinjalizimi përmban, sipas rastit:
 - a) të dhënat e identitetit dhe të kontaktit të sinjalizuesit, përveç rasteve kur sinjalizimi bëhet në mënyrë anonime;
 - b) organin ose personin e përfshirë, ndaj të cilit raportohet shkelja;
 - c) përshkrimin e informacionit për shkeljen e mundshme, të shoqëruar me fakte, rrethana e dokumentacion mbështetës, për aq sa është e mundur;
 - ç) referimin përkatës të legjislacionit të shkelur, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi.
3. Kur sinjalizimi bëhet nëpërmjet një linje telefonie ose sistemi tjetër mesazhesh zanore të regjistruara, sinjalizuesi informohet paraprakisht për regjistrimin dhe sinjalizimi dokumentohet me regjistrim zanor ose me transkript të plotë; kur regjistrimi nuk është i mundur, biseda përshkruhet me shkrim, në mënyrë të detajuar. Sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen e dokumentuar, duke nënshkruar dokumentin përkatës.
4. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim, sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje.
5. Kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së parashikuar në këtë nen, sinjalizuesi njoftohet me shkrim që të korrigjojë këto të meta, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 10

Sinjalizimi anonim

1. Sinjalizimet anonime trajtohen nga NJP në të njëjtën mënyrë si çdo sinjalizim tjetër, pa vendosur kushte shtesë për marrjen, shqyrtimin dhe verifikimin e tyre.
2. Nëse sinjalizuesi nuk jep pëlqimin e tij të shprehur për identifikim, sinjalizimi trajtohet si sinjalizim anonim.
3. Identiteti i sinjalizuesit anonim, në rastet kur identifikohet, mund të bëhet i njohur vetëm me pëlqimin e tij të shprehur ose me kërkesë të organeve procedurale kompetente, në përputhje me ligjin.

Neni 11

Sinjalizimi i jashtëm dhe sinjalizimi publik

1. Sinjalizuesi mund t'i drejtohet ILDKPKI-së drejtpërdrejt, në çdo fazë dhe pa u kushtëzuar nga sinjalizimi i brendshëm. Kjo e drejtë vlen veçanërisht kur:
 - a) vlerëson se shkelja nuk mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda DPSHTRR-së, ose kur ekziston rrezik veprimesh hakmarrëse ndaj tij ose personave të lidhur me të;



b) ka paraqitur fillimisht sinjalizimin pranë NJP-së dhe nuk është informuar për ecurinë ose trajtimin e tij, brenda afateve të parashikuara në këtë rregullore.

2. Sinjalizuesi që sinjalizon publikisht një shkelje të mundshme përfiton mbrojtjen e parashikuar nga ligji, nëse plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) ka bërë më parë sinjalizim të brendshëm dhe/ose të jashtëm dhe nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme si përgjigje ndaj tij, brenda afateve përkatëse;

b) ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se shkelja përbën rrezik të menjëhershëm ose të dukshëm për interesin publik, përfshirë situata emergjence, ose rrezik dëmi të pariparueshëm;

c) ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se, në rast sinjalizimi të jashtëm, ekziston mundësi e ulët që shkelja të trajtohet në mënyrë efektive, për shkak të rrezikut të fshehjes a të shkatërrimit të provave, të hakmarrjes, ose të përfshirjes a bashkëpunimit të autoritetit kompetent në shkelje.

Neni 12

Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen nga NJP në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik, të krijuar për regjistrimin e sinjalizimeve.

2. NJP nuk mund të refuzojë, për asnjë shkak, regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 13

Këshillimi përpara raportimit

1. Nëse një person kërkon këshillim përpara regjistrimit të sinjalizimit, punonjësit e NJP-së i japin informacion të përgjithshëm mbi të drejtat që gëzon sinjalizuesi, sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje, dhe mbi procesin e sinjalizimit në tërësi.

2. Punonjësi që angazhohet në dhënien e këshillimit për një rast të caktuar nuk mund të ushtrojë, për të njëjtin rast, detyrën e punonjësit të autorizuar për trajtimin e sinjalizimit.

3. Veprimtaria këshilluese nuk konsiderohet sinjalizim, në kuptim të ligjit dhe të kësaj rregulloreje, dhe nuk regjistrohet në regjistrin e sinjalizimeve.

KREU IV

TË DREJTAT E SINJALIZUESIT PËR MBROJTJE NGA HAKMARRJA

Neni 14

E drejta për mbrojtje

1. Mbrojtja e sinjalizuesit nga çdo formë hakmarrjeje sigurohet nëpërmjet mekanizmave të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore.

2. Sinjalizuesi gëzon të drejtat e mëposhtme:

a) mbrojtje nga të gjitha format e veprimeve hakmarrëse;

b) mbrojtje të identitetit dhe ruajtje të konfidencialitetit gjatë gjithë procesit të sinjalizimit dhe të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje, përfshirë rastet e sinjalizimit anonim;

c) ruajtje të konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuar;

ç) ndihmë juridike falas, në përputhje me ligjin nr. 11/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti";



d) kompensim të dëmit të shkaktuar si rezultat i veprimeve hakmarrëse.

3. Ndihmësi, personat e lidhur me sinjalizuesin, si dhe personat juridikë që sinjalizuesi i zotëron, për të cilët punon, ose me të cilët është i lidhur në një kontekst pune, gëzojnë të njëjtat të drejta mbrojtjeje, sipas pikës 2 të këtij neni, sipas shtrirjes së parashikuar në nenin 16 të kësaj rregulloreje.

4. Sinjalizuesi nuk mban përgjegjësi ligjore për marrjen ose aksesimin e informacionit që raportohet ose publikohet, për sa kohë që ky veprim nuk përbën, më vete, vepër penale. Në rastet kur marrja ose aksesimi përbën vepër penale, përgjegjësia penale vlerësohet dhe trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.

5. Çdo rregull ose marrëveshje private, individuale ose kolektive, që synon të përjashtojë ose të kufizojë të drejtat e sinjalizuesit, është e pavlefshme dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik. Të drejtat e sinjalizuesit kanë epërsi ndaj çdo marrëveshjeje për konfidencialitetin.

6. DPSHTRR-ja, nëpërmjet NJP-së, informon sinjalizuesin për të drejtat dhe për mekanizmat e mbrojtjes që ofrohen sipas ligjit dhe sipas kësaj rregulloreje.

Neni 15

Kushtet për mbrojtjen e sinjalizuesit

1. Sinjalizuesi gëzon të drejtën për mbrojtje, pavarësisht mekanizmit të sinjalizimit të përdorur, kur plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) ka pasur shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni i sinjalizuar ose i bërë publik ishte i vërtetë në momentin e sinjalizimit, pavarësisht nëse më pas rezulton ndryshe;

b) ka pasur shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni i sinjalizuar përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit;

c) sinjalizimi është kryer në përputhje me ligjin, nëpërmjet kanalit të brendshëm pranë NJP-së, kanalit të jashtëm pranë ILDKPKI-së, ose nëpërmjet publikimit, sipas kushteve të parashikuara në ligj.

2. Sinjalizuesi që ka sinjalizuar në mënyrë anonime gëzon të drejtën për mbrojtje, sipas pikës 1 të këtij neni, edhe nëse identiteti i tij zbulohet më vonë pa pëlqimin e tij dhe bëhet objekt i veprimeve hakmarrëse.

3. Sinjalizuesi që sinjalizon publikisht, sipas kushteve të parashikuara në ligj, gëzon të drejtën për mbrojtje në të njëjtat kushte.

Neni 16

Shtrirja e mbrojtjes të ndihmësi dhe të personat e lidhur me sinjalizuesin

1. Ndihmësi, personat e lidhur me sinjalizuesin, përfshirë bashkëshortin, bashkëjetuesin, të afërmit e tij, si dhe kolegët e të afërmeve që punojnë për të njëjtin punëdhënës ose që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin kontekst pune, si dhe personat juridikë që sinjalizuesi i zotëron, për të cilët punon, ose me të cilët është i lidhur në një kontekst pune, gëzojnë të njëjtën mbrojtje nga veprimet hakmarrëse, sipas kësaj rregulloreje, kur kanë qenë objekt i tyre për shkak të lidhjes së tyre me sinjalizuesin.

2. Mbrojtja e parashikuar në pikën 1 të këtij neni garantohet gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, pas përfundimit të saj, për të siguruar vijimin normal të marrëdhënies së punës, si dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës me DPSHTRR-



në, kur kërkesa për mbrojtje është paraqitur pranë ILDKPKI-së mbi bazën e rrethanave të arsyeshme.

3. Të afërmit e sinjalizuesit, edhe kur nuk kanë marrëdhënie pune me DPSHTRR-në, përfitojnë nga ndalimi i çdo forme presioni, kërcënimi ose ngacmimi që mund të ushtrohet ndaj tyre për shkak të sinjalizimit, sipas nenit 19 të kësaj rregulloreje, si dhe nga konfidencialiteti i identitetit, sipas dispozitave për konfidencialitetin e parashikuara në Rregulloren për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit.

Neni 17

Masat për mbrojtjen e personave të përfshirë

1. Personat e përfshirë në sinjalizim, përfshirë ata ndaj të cilëve është bërë raportimi ose publikimi i shkeljes, gëzojnë të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe për një proces të rregullt ligjor, përfshirë parimin e prezumimit të pafajësisë, të drejtën për mbrojtje, të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën për t'u njohur me dokumentacionin përkatës.
2. DPSHTRR-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi, garanton mbrojtjen e identitetit të personave të përfshirë, për sa kohë që hetimi i nisur si rezultat i sinjalizimit ose publikimit është në proces.
3. Dispozitat e ligjit dhe të Rregullores për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, që rregullojnë konfidencialitetin dhe mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesit, zbatohen në mënyrë të njëjtë edhe për personat e përfshirë, deri në përfundimin e procedurave administrative përkatëse.

KREU V

VEPRIMET HAKMARRËSE DHE MASAT PARANDALUESE TË BRENDSHME

Neni 18

Llojet e veprimeve hakmarrëse

Sinjalizuesi që sinjalizon një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor gëzon mbrojtje ndaj çdo veprimi hakmarrës të ndërmarrë nga DPSHTRR-ja kundrejt tij, ndër të tjera:

- a) shkarkimi nga puna;
- b) pezullimi nga detyra, ose nga një a më shumë detyra;
- c) transferimi brenda ose jashtë DPSHTRR-së, ose ndryshimi i orarit të punës;
- ç) ulja në detyrë;
- d) ulja e pagës dhe e shpërblimeve financiare;
- dh) humbja e statusit profesional ose e privilegjeve të lidhura me pozicionin;
- e) mohimi i mundësisë për ngritje në detyrë;
- ë) heqja e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- f) vlerësimi negativ në marrëdhënien e punës;
- g) intimidimi, ngacmimi, presioni psikologjik ose përjashtimi nga ambienti i punës;
- gj) diskriminimi ose trajtimi i padrejtë;
- h) mosrinovimi i kontratës së përkohshme në një kontratë të përhershme, kur punonjësi kishte pritshmëri të ligjshme për punësim të përhershëm;
- i) përfundimi ose mosrinovimi i kontratës së përkohshme;



- j) dëmtimi i reputacionit, kryesisht në mediat sociale, ose humbja e të ardhurave apo e mundësive të biznesit;
- k) përfshirja në “listë të zezë”, nëpërmjet marrëveshjeve formale ose informale, që pengojnë punësimin e sinjalizuesit në sektorin përkatës në të ardhmen;
- l) përfundimi ose anulimi i parakohshëm i kontratës për mallra ose shërbime;
- ll) anulimi i licencës ose i lejes së ushtrimit të aktivitetit;
- m) referimi i pajustificuar për ekzaminim psikiatrik ose mjekësor;
- n) kërcënim i përpjekja për të ndërmarrë secilin nga veprimet e mësipërme;
- nj) izolimi profesional, përjashtimi nga proceset vendimmarrëse ose marginalizimi i heshtur në ambientin e punës.

Neni 19

Ndalimi dhe pavlefshmëria e veprimeve hakmarrëse

1. Pengimi, ndërhyrja, përpjekja ose kërcënim për të penguar sinjalizimin, në çfarëdo formë, janë të ndaluara dhe të dënueshme sipas ligjit.
2. Çdo akt, kontratë ose marrëveshje, individuale ose kolektive, që parashikon ndalimin ose kufizimin e të drejtës për sinjalizim, është e pavlefshme dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik.
3. Veprimet hakmarrëse, përpjekjet ose kërcënimet për veprime hakmarrëse, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, ndaj sinjalizuesit ose personave të lidhur me të, për shkak të sinjalizimit të brendshëm, të jashtëm, anonim ose publik, janë të ndaluara dhe të pavlefshme.
4. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit, ndihmësit ose personave të lidhur me të është i pavlefshëm dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik.

Neni 20

Kërkesa për zhvendosje brenda DPSHTRR-së

1. Nëse sinjalizuesi kërkon të vendoset në një strukturë tjetër të DPSHTRR-së, për shkak të krijimit të një mjedisi pune armiqësor si pasojë e sinjalizimit, paraqet kërkesë me shkrim pranë Drejtorit të Përgjithshëm ose pranë NJP-së.
2. DPSHTRR-ja merr masat e nevojshme për realizimin e kësaj zhvendosjeje, brenda kohës më të shkurtër të mundshme, duke respektuar dinjitetin dhe pozicionin profesional të sinjalizuesit.
3. Në rast të mosmarrjes së masave brenda një afati të arsyeshëm, ILDKPKI-ja, me kërkesë të sinjalizuesit, i drejtohet DPSHTRR-së për të urdhëruar marrjen e masave përkatëse.
4. Kërkesa dhe trajtimi i saj, sipas këtij neni, janë konfidenciale dhe nuk varen nga ekzistenca e një hetimi paralel pranë ILDKPKI-së për veprime hakmarrëse.



KREU VI
PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR MBROJTJE PRANË
ILDKPKI-SË

Neni 21

Paraqitja e kërkesës për mbrojtje

1. Sinjalizuesi që vlerëson se është bërë, është duke u bërë ose rrezikon të bëhet objekt i një veprimi hakmarrës, për shkak të sinjalizimit, paraqet kërkesë për mbrojtje me shkrim pranë ILDKPKI-së, si autoritet kompetent sipas ligjit.
2. Sinjalizuesi mund të informojë njëkohësisht, edhe NJP-në e DPSHTRR-së, e cila bashkëpunon me ILDKPKI-në gjatë gjithë procedurës së shqyrtimit të kërkesës.

Neni 22

Verifikimi paraprak i kërkesës nga ILDKPKI-ja

1. ILDKPKI-ja kryen verifikimin paraprak të kërkesës për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse, për të verifikuar nëse:
 - a) sinjalizuesi plotëson kushtet e parashikuara në nenin 15 të kësaj rregulloreje, për të gëzuar të drejtën për mbrojtje;
 - b) ekziston lidhje e arsyeshme midis sinjalizimit të kryer për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor dhe veprimit hakmarrës të ndërmarrë nga DPSHTRR-ja kundrejt sinjalizuesit.
2. Në rast se nuk plotësohen kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ILDKPKI-ja vendos rrëzimin e kërkesës për mbrojtje.
3. Në rast se plotësohen kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ILDKPKI-ja, gjatë verifikimit paraprak, por jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga paraqitja e kërkesës, shqyrton nevojën për marrjen e një vendimi të ndërmjetëm të arsyetuar, sipas nenit 24 të kësaj rregulloreje.
4. ILDKPKI-ja njofton sinjalizuesin për rezultatet e verifikimit paraprak, brenda 7 (shtatë) ditëve nga regjistrimi i kërkesës.

Neni 23

Regjistrimi dhe njoftimi nga ILDKPKI-ja

1. ILDKPKI-ja regjistron dhe shqyrton kërkesën për të vlerësuar nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të besuar se një veprim hakmarrës ka ndodhur, është duke ndodhur, ose pritet të ndodhë.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës, ILDKPKI-ja njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e saj dhe e njofton për emrin e punonjësit përgjegjës për ndjekjen e çështjes.
3. ILDKPKI-ja njofton me shkrim sinjalizuesin, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, për statusin e hetimit administrativ dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë, dhe i përgjigjet çdo kërkesë të mëtejshme për informacion të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi.



Neni 24

Vendimi i ndërmjetëm për pezullimin e veprimeve hakmarrëse

1. ILDKPKI-ja merr masa të menjëhershme, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga paraqitja e kërkesës, kur çmon se ekziston rreziku i një veprimi hakmarrës, dhe vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar, pezullimin e çdo veprimi hakmarrës ndaj sinjalizuesit deri në përfundimin e hetimit.
2. Vendimi i ndërmjetëm përfshin:
 - a) ndalimin për DPSHTRR-në që të ndërmarrë veprime të reja hakmarrëse ndaj sinjalizuesit, deri në përfundimin e hetimit administrativ;
 - b) pezullimin e çdo veprimi hakmarrës të ndërmarrë ndaj sinjalizuesit, deri në përfundimin e hetimit.
3. Vendimi i ndërmjetëm përmban llojin e masës së urdhëruar, subjektin ndaj të cilit drejtohet, dhe kohëzgjatjen e saj.
4. Vendimi i ndërmjetëm i njoftohet vetëm sinjalizuesit, përveç rasteve kur zbatimi i tij kërkon ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të DPSHTRR-së për ndalimin e një veprimi të identifikuar.

Neni 25

Procesi i rregullt në hetimin e kërkesës

Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin e kërkesës për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse i garantohet një procesi të rregullt, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, përfshirë:

- a) të drejtën për të dhënë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
- b) të drejtën për t'u njohur me dosjen e hetimit, me përjashtim të të dhënave të sinjalizuesit dhe të çdo informacioni që mund të çojë në identifikimin e tij, të cilat paraqiten në mënyrë të anonimizuar;
- c) të drejtën për t'u dëgjuar në lidhje me pretendimet e parashtruara.

Neni 26

Bashkëpunimi i DPSHTRR-së dhe barra e provës

1. ILDKPKI-ja, në hetimin administrativ, i kërkon me shkresë DPSHTRR-së të provojë se masat e marra ndaj sinjalizuesit janë bazuar në shkaqe të ndryshme nga sinjalizimi, dhe që nuk lidhen, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me të.
2. DPSHTRR-ja ka barrën e provës në këtë proces dhe i përgjigjet ILDKPKI-së me shkrim, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.
3. DPSHTRR-ja dhe sinjalizuesi bashkëpunojnë me ILDKPKI-n në përcaktimin e fakteve dhe të rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes së veprimeve hakmarrëse ndaj sinjalizuesit.
4. DPSHTRR-ja është e detyruar të paraqesë informacione, prova, dokumente, deklarata, ose të paraqitet personalisht përpara ILDKPKI-së, me kërkesë të saj.
5. NJP koordinon mbledhjen dhe transmetimin e informacionit e të dokumentacionit të kërkuar nga ILDKPKI-ja, duke ruajtur konfidencialitetin sipas dispozitave të Rregullores për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit.



Neni 27

Mjetet e kërkimit të provës nga ILDKPKI-ja

1. Gjatë hetimit administrativ, ILDKPKI-ja, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe të rrethanave të çështjes, mund:

- a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;
- b) të marrë dokumente dhe prova të tjera, të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit, ose në çdo mënyrë tjetër të ligjshme;
- c) të vizitojë vende të caktuara në DPSHTRR;
- ç) të urdhërojë inspektime ose analiza.

2. Kur një provë ka rrezik të zhdukët, ose marrja e saj rrezikon të vështirësohet apo të bëhet e pamundur, ILDKPKI-ja, kryesisht ose me kërkesën e sinjalizuesit, mund të vendosë sigurimin e saj më parë, edhe përpara fillimit të procedurës administrative ose në çdo fazë të saj. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi ILDKPKI.

Neni 28

Afati i përfundimit të hetimit

Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e regjistrimit të kërkesës pranë ILDKPKI-së.

Neni 29

Masat në përfundim të hetimit dhe zbatimi i tyre nga DPSHTRR-ja

- 1. Nëse, në përfundim të hetimit administrativ, rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit, ILDKPKI-ja urdhëron DPSHTRR-në, sipas legjislacionit në fuqi, të marrë të gjitha masat për riparimin e shkeljes së kryer, duke parashikuar në shkresë edhe rekomandimin konkret për llojin e masës që duhet të merret.
- 2. DPSHTRR-ja zbaton masat e urdhëruara nga ILDKPKI-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës/urdhrit.
- 3. Nëse DPSHTRR-ja nuk zbaton masat e urdhëruara, brenda afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, sinjalizuesi ose çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente.
- 4. NJP ndjek dhe raporton te Drejtori i Përgjithshëm zbatimin e masave të urdhëruara nga ILDKPKI-ja.

KREU VII

PËRJASHTIMI NGA PËRGJEGJËSIA DHE KOMPENSIMI I DËMIT

Neni 30

Përgjashtimi nga përgjegjësia ligjore

1. Sinjalizuesi që sinjalizon, në përputhje me ligjin, një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, nuk konsiderohet shkelës i ndonjë ndalese për informacionin e raportuar ose publikuar, dhe nuk mban përgjegjësi ligjore për këtë veprim, me kusht që të ketë pasur shkaqe të arsyeshme për të besuar se raportimi ose publikimi ishte i nevojshëm për të zbuluar shkeljen.



2. Nisja e procedimeve disiplinore, civile ose administrative ndaj sinjalizuesit, ndihmësit, personave të lidhur me ta, ose personave juridikë që sinjalizuesi i zotëron, për shkak të sinjalizimit të kryer në përputhje me ligjin, ndalohej, duke përfshirë procedimet për shpifje, shkelje të sekretit, cënim të privatësisë, shkelje të sekreteve tregtare apo të të drejtave të autorit, kur sinjalizuesi ka pasur shkaqe të arsyeshme të besojë se sinjalizimi ishte i nevojshëm për zbulimin e shkeljes.

Neni 31

Mjetet juridike dhe e drejta për kompensim

1. Sinjalizuesi, ndihmësi, personat e lidhur me sinjalizuesin, si dhe personat juridikë që sinjalizuesi i zotëron, kanë akses në mjete juridike mbrojtëse kundër veprimeve hakmarrëse, përfshirë masat e përkohshme, deri në përfundimin e procedurave përkatëse.
2. Sinjalizuesi, ndihmësi dhe personat e lidhur me sinjalizuesin kanë të drejtë të kërkojnë, pranë gjykatës, kompensim për dëmin e shkaktuar nga veprimet hakmarrëse, si dhe urdhërimin e masave të përkohshme, kur e shohin të nevojshme.

Neni 32

Kompensimi i dëmit në rastet e sinjalizimit në keqbesim

1. Sinjalizimi kryhet me përgjegjshmëri, pa shpifur, pa mashtruar ose pa dhënë informacion të rremë, në dëm të personave të përfshirë.
2. Nëse, gjatë shqyrtimit gjyqësor, provohet se sinjalizuesi, me dijeni të plotë, ka kryer një sinjalizim të rremë, personave të dëmtuar u lind e drejta të kërkojnë kompensimin e dëmit të shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VIII

RAPORTIMI DHE PËRGJEGJËSIA ADMINISTRATIVE

Neni 33

Raportimi vjetor

1. NJP paraqet pranë ILDKPKI-së, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raportin vjetor të konsoliduar për sinjalizimet e marra dhe trajtimin e tyre, sipas formatit të përcaktuar nga ILDKPKI-ja.
2. NJP i raporton periodikisht Drejtorit të Përgjithshëm mbi ecurinë e sinjalizimeve dhe të masave të ndërmarra, duke garantuar konfidencialitetin e identitetit të sinjalizuesve.

Neni 34

Përgjegjësia administrative

Shkelja e dispozitave të ligjit dhe të kësaj rregulloreje nga punonjësit e DPSHTRR-së, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas nenit 27 të ligjit, ndër të tjera, për mosaktimin e NJP-së, mospërmblidhjen e detyrimit për raportim vjetor, pengimin a kërcënimin për të penguar sinjalizimin, çdo veprim hakmarrës, mosfillimin apo përfundimin e parregullt të hetimit, si dhe sinjalizimin e rremë të kryer me vetëdije.



KREU IX DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35 *Hyrja në fuqi*

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Drejtori i Përgjithshëm i DPSHTRR-së. Çdo akt i brendshëm rregullativ i cili bie ndesh me këtë rregullore, shfuqizohet.

Bashkëlidhur kësaj rregullore janë formularët përkatës dhe janë pjesë përbërëse e saj si më poshtë:

Aneksi 1. Formular i Sinjalizimit të Brendshëm;

Aneksi 2. Formular i Kërkesës për Mbrojtje nga Hakmarrja;

Aneksi 3. Formular Raportimi i Njësive Përgjegjëse;

Aneksi 4. Regjistri i Sinjalizimit të Brendshëm në Njësinë Përgjegjëse në DPSHTRR.

Miratur me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 996, datë 9.07.2026



Aneksi 1.

FORMULAR I SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM

DREJTUAR: Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në zbatim të ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

1- Identiteti i sinjalizuesit:

☐ Sinjalizuesi _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në _____.

☐ Sinjalizues anonim, me kontakt _____.

*Shënim: Të dhënat e kontaktit nuk janë të detyrueshme për sinjalizuesin anonim. Ato kërkohen për të pasur mundësinë e vijimit të komunikimit me sinjalizuesin në funksion të hetimit.

2- Konteksti i punës së sinjalizuesit:

☐ I punësuar pranë autoritetit/subjektit të sinjalizuar.

☐ I punësuar më parë pranë autoritetit/subjektit të sinjalizuar.

☐ I vetëpunësuar

☐ Ofrues shërbimesh/furnizimi/nënkontraktor.

☐ Kontekst pune tjetër (specifiko): _____

3- Përshkrimi i fakteve e rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprime të kundërligjshme apo shkelje të kuadrit ligjor:

4- Parashikime të legjislacionit apo dispozita ligjore, për të cilat parashtrohet shkelja apo veprimi i kundërligjshëm (nëse është e mundur ta përcaktoni një gjë të tillë):

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e veprimeve të kundërligjshme apo shkeljeve të kuadrit ligjor të parashikuara në:

5- Aktet provuese në mbështetje të sinjalizimit:



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati Bjorn, Tiranë AL, 1010;
Tel.: +355 68 801 5833; Fax.: +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më ____/____/____, në _____ nga z./znj. _____, nëpunësi i Njesisë Përgjegjëse në Autoritetin Publik/Subjektin Privat _____.

Sinjalizuesi
Emër Mbiemër

Nëpunësi Përgjegjës për Sinjalizimin
Emër Mbiemër



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati Bjorn, Tiranë AL.1010;
Tel.: +355 68 801 5833; **Fax.:** +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

Ankesi 2.

FORMULAR KËRKESË PËR MBROJTJE NGA VEPRIMET HAKMARRËSE

DREJTUAR: Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në zbatim të ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

1- Identiteti i sinjalizuesit, ndihmësit apo personit të lidhur.

☐ Sinjalizuesi

☐ Ndihmësi

☐ Personi i lidhur

Z./Znj. _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në _____.

1/1- Në rast se kërkuesi është ndihmës apo person i lidhur:

Përshkruani marrëdhënien me sinjalizuesin në funksion të sinjalizimit:

2- Identifikimi i sinjalizimit të kryer.

Kjo kërkesë lidhet me kryerjen në datën ____/____/_____, të sinjalizimit:

☐ Të jashtëm pranë ILDKPKI

☐ Të brendshëm pranë Njesisë përgjegjëse të:

a. Autoritet

Publik:

b. Subjekt

Privat:

☐ Publik

3- Përshkrimi i fakteve e rrethanave të njohura nga sinjalizuesi, ndihmësi apo personi i lidhur për veprime hakmarrëse të ndërmarra ndaj tij.

Për shkak të sinjalizimit të kryer, pretendoj se jam subjekt i veprimeve hakmarrëse të marra ndaj meje si në vijim:



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati Bjorn, Tiranë AL, 1010;
Tel.: +355 68 801 5833; **Fax.:** +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

4- Aktet provuese në mbështetje të kërkesës:

Bashkëlidhur kësaj kërkesë, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

Ky formular kërkesë për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse u mor në dorëzim më ____/____/____, në _____ nga _____, nëpunësi në ILDKPKI.

Kërkuesi

Emër Mbiemër

**Nëpunësi Përgjegjës për
Sinjalizimin në ILDKPKI**

Emër Mbiemër



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati Bjorn, Tiranë AL.1010;
Tel.: +355 68 801 5833; **Fax.:** +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

Aneksi 3.

FORMULAR RAPORTIMI I NJËSIVE PËRGJEGJËSE

DREJTUAR: Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në zbatim të ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

I. IDENTIFIKIMI I NJËSISË PËRGJEGJËSE:

- Emërtimi i autoritetit publik/subjektit privat:
- Nëpunësi/t përgjegjës për sinjalizimin/pala e tretë e kontraktuar:
- Periudha e raportimit:
- Të dhënat e kontaktit:

II. TË DHËNA MBI NJËSINË PËRGJEGJËSE:

- Data e krijimit të Njesisë:
- Forma e organizimit:
 - ☐ Njësi brenda Autoritetit Publik/Subjektit Privat
 - ☐ Njësi e përbashkët midis disa subjekteve
 - ☐ Palë e tretë e kontraktuar
- Mjetet e sinjalizimit që mundësohen nga Njësia:
 - ☐ Sinjalizim verbal
 - ☐ Sinjalizim me shkrim
 - ☐ Mjete digjitale

III. STATISTIKA MBI SINJALIZIMET E REGJISTRUARA:

- Të dhëna mbi sinjalizimet:
 - a. Numri i përgjithshëm i sinjalizimeve të regjistruara: _____
 - b. Numri i sinjalizimeve të ndarë sipas formës së sinjalizimit:



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati Bjorn, Tiranë AL.1010;
Tel.: +355 68 801 5833; **Fax.:** +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

_____ (sinjalizues i identifikuar) / _____ (anonim) / _____ (anonim por identifikuar gjatë hetimit).

- Numri i rasteve të ndara sipas kontekstit të punës së sinjalizuesit:
 - a. Sinjalizues është person i punësuar: _____
 - b. Sinjalizues ka qenë person i punësuar më parë: _____
 - c. Sinjalizuesi është subjekt kontraktor apo palë e tretë e lidhur në një kontekst pune: _____
 - ç. Tjetër kontekst pune (specifiko): _____

- Fusha e sinjalizimeve (numri i rasteve të ndara sipas fushës së sinjalizimit):
 - ☐ Kundërvajtje administrative: _____

 - ☐ Vepër penale: _____

 - ☐ Prokurim publik: _____

 - ☐ Shërbime financiare / parandalimi i pastrimit të parave: _____

 - ☐ Mbrojtja e të dhënave personale/e drejta e informimit: _____

 - ☐ Deklarim pasurie / konflikt interesash: _____

 - ☐ Shëndeti publik: _____

 - ☐ Mbrojtja e mjedisit: _____

 - ☐ Tjetër (specifiko fushat dhe numrin e rasteve): _____

IV. ADMINISTRIMI DHE HETIMI I SINJALIZIMEVE

- Numri i sinjalizimeve për të cilët është dërguar konfirmimi i regjistrimit brenda 7 ditëve: _____
- Numri i hetimeve të përfunduara brenda 90 ditëve: _____
- Kohëzgjatja mesatare e përfundimit të hetimit të rasteve të sinjalizuara: _____ ditë.
- Statusi i procedurave:
 - a. Numri i hetimeve të përfunduara gjatë vitit raportues: _____
 - b. Numri i hetimeve për të cilat vijon hetimi në përfundim të periudhës raportuese: _____

V. REZULTATET E PROCEDURËS HETIMORE

- Rastet e përfunduara apo mosfilluara:
 - a. Numri i sinjalizimeve të përfunduara si të bazuara: _____
 - b. Numri i sinjalizimeve të përfunduara si të pabazuara në fakte dhe të dhëna: _____
 - c. Numri i sinjalizimeve të përfunduara me të dhëna të rreme ose të pasakta: _____



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati Bjorn, Tiranë AL, 1010;
Tel.: +355 68 801 5833; **Fax.:** +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

- ç. Numri i sinjalizimeve të mosfilluara (me të meta/jashtë fushës së zbatimit të ligjit/nuk ka elementë të kundërligjshëm nga shqyrtimi paraprak): ____ / ____ / ____
- Masat e marra në vijim të përfundimit të hetimit:
- ☐ Fillim procedure disiplinore për personat e gjetur në shkelje: ____
- ☐ Masa administrative: ____
- ☐ Referim në organet e prokurorisë: ____
- ☐ Referim pranë organit kompetent: ____
- ☐ Masa të tjera të ndërmarra për rregullimin e pasojave (specifiko):
- _____
- _____
- _____

VI. ASISTENCA DHE MASAT PËR MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT

- Numri i rasteve të këshillimit mbi sinjalizimin: _____
- Masa të ndërmarra për ruajtjen e konfidencialitetit, mbrojtjen e të dhënave dhe administrimin e dokumentacionit (specifiko):
- _____
- _____
- Numri i trajnimeve dhe personave të trajnuar mbi sinjalizimin:
- _____
- _____
- Problematika të identifikuar lidhur me procesin e sinjalizimit dhe hetimit të sinjalizimeve (specifiko):
- _____
- _____
- _____

Ky raport u hartua më ____ / ____ / ____, në _____ nga z./znj. _____, nëpunësi i Njesisë Përgjegjëse pranë Autoritetit Publik/Subjektit Privat _____.

NJËSIA PËRGJEGJËSE

Emër Mbiemër



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati Bjorn, Tiranë AL.1010;
Tel.: +355 68 801 5833; **Fax.:** +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

Aneksi 4.

REGJISTRI I SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM NË NJËSINË PËRGJEGJËSE NË DPSHT

Nr.	Sinjalizuesi dhe Funksioni	Autoritet Publik/Subjekt Privat	I Sinjalizuar dhe funksioni	Përshkrimi i objektit të sinjalizimit	Rregjistrimi i Kërkesës		Mosfillim Hetimi		Fillim Hetimi		Përfundimi i Hetimit		Masat/Njoftime Prokurorisë/Policiës	Kthim përgjigje sinjalizuesit	Ecuria
					Nr. Datë	Nr. Datë	Nr. Datë	Nr. Datë	Nr. Datë	Nr. Datë	Nr. Datë				
1															
2															
3															



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati Bjorn, Tiranë AL, 1010;
Tel.: +355 68 801 5833; **Fax.:** +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al